

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Efekti sezonal, depozitat në euro në gusht rriten me 236 milionë euro, ngadalësohen kursimet në lekë
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/29/efekti-sezonal-depozitat-ne-euro-ne-gusht-rriten-me-236-milione-euro-ngadalesohen-kursimet-ne-leke/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 09:04:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 09:02:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dbda1d0591ac1e2fd7000afe08545f82837f3e770373759d3acce48714e8f515
TEKSTI	a22ea165ecb70a1cfb2a23febcbf7869ecd86bab9fbb69c73bb5a7f3ea9789e2
PAMJA	95eb4c3bdb54c7d5555400338de714a3c7afb6efa90e6c37796abfa2432ef8e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8f04a61113aaad882fa7f1ef56624d6a6c9292542fdb7b9030c7374e5ea1f0a9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8f04a61113aaad882fa7f1ef56624d6a6c9292542fdb7b9030c7374e5ea1f0a9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Efekti sezonal, depozitat në euro në gusht rriten me 236 milionë euro, ngadalësohen kursimet në lekë

11:02 : 29/09/2026 në AKTUALITET, EKONOMI



Depozitat që bizneset dhe individët kanë në banka kanë vazhduar rritjen në gusht, por ndryshe nga **korriku** kur dominonte monedha vendase, janë udhëhequr nga kursimet në valutë, të ndikuara nga efektet sezonale të turizmit.

Sipas të dhënave të publikuara nga banka e Shqipërisë, në gusht, stoku i depozitave në lekë arriti në 789.4 miliardë lekë. Në krahasim me korrikun e po këtij viti, kursimet u rritën me gati 1%, ose 7.5 miliardë lekë.

Rritja është shumë më e ngadaltë se periudha prill-korrik, kur shtesa mujore i kishte kaluar 10 miliardë lekët.

Ndikimin kryesor në korrik e dhanë korporatat jo financiare, ndërsa shtesa e kursimeve të individëve ishte minimale.

Lexo edhe:

[Këmbimi valutor 29 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja](#)

[Këmbimi valutor 28 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja](#)

Me bazë vjetore, (korrik 2026/korrik 2025), depozitat në lekë janë rritur me 17.5%, ose 118 miliardë lekë më shumë.


Ndryshe nga leku, që u ngadalësua, depozitat në valutë përshpejtuan ndjeshëm ritmet e rritjes në gusht, të ndikuara nga efektet sezonale, si të prurjeve të emigrantëve ashtu dhe të hyrave që vijnë nga turizmi, që arrin kulmin në muajin në fjalë.

Depozitat në euro, sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë arritën në 9.5 miliardë lekë në korrik, me një rritje prej 2.54%, ose 236 milionë euro më shumë në krahasim me korrikun e 2026-s. Rritja erdhi si nga bizneset ashtu dhe individët.

Në gusht të një viti më parë, depozitat në euro ishin rritur me 227 milionë euro.

Me bazë vjetore, (korrik 2026/korrik 2025), depozitat në euro janë rritur me 12.3%, ose rreth 1 miliardë euro më shumë.

TË GJITHA



Efekti sezonal, depozitat në euro në gusht rriten me 236 milionë euro, ngadalësohen kursimet në lekë

11:02 : 29/09/2026



Erëndë në Greqi/ Humb jetën 16-vjeçari shqiptar, u dëmtua në kokë gjatë një ndeshjeje futbolli (EMRI)

10:51 : 29/09/2026



Kapja e 22 ton kokainë/ Mediat e Ekuadorit: Mafia shqiptare tentoi të korrte agjentë të inteligjencës

10:36 : 29/09/2026



Putin firmos dekretin e ri, ushtria ruse shtohet me 15,500 trupa

10:28 : 29/09/2026



13 burra pas Vlora Hysenit

10:26 : 29/09/2026



EMRI/ I dënuar për vrasje, arrestohet në Itali 28-vjeçari shqiptar, pritet ekstradimi

10:05 : 29/09/2026



Komisioni Evropian propozon kufizimin e të drejtave për anëtarët e ardhshëm të BE-së

10:02 : 29/09/2026

Të konvertuara në euro, me kursin aktual, shtesa vjetore totale e depozitave (gusht 2026/gusht 2025) ishte rreth 2.3 miliardë euro, me rreth 55% të shtesës që erdhi nga monedha vendase.

Banka e Shqipërisë raporton stokun e depozitave të konvertuara në lekë, që arriti në 1.58 miliardë lekë në gusht, nga të cilat 789 miliardë lekë në monedhën vendas, dhe po 789 miliardë lekë në euro, por vlera e euros e konvertuar në lekë është e zhvlerësuar, për shkak të kursit./ Monitor

Etiketa: euro lekë

Lajme të lidhura



Këmbimi valutor 29 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja

08:31 : 29/09/2026



Këmbimi valutor 28 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja

08:07 : 28/09/2026



Këmbimi valutor 27 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja

08:43 : 27/09/2026



Këmbimi valutor 26 shtator/ Me sa blihen e shiten monedhat e huaja

09:00 : 26/09/2026



Si rrallëherë këtë vit, Euro e mbyll javën në rritje

13:53 : 25/09/2026



Euro vijon "rrokullisjen", prek rekord të ri në vlerën e 91.4 lekëve

15:48 : 22/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun

NA NDIQ

f i g y

mediatik.
Na kontakto:

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.